



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 14:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes datë 05 nëntor 2019
2. Shqyrtimi dhe miratimi I Kalendarit të punimeve të Komisionit për Integrimin Europian për periudhën 25 nëntor– 20 dhjetor 2019 I integruar me kalenadrin për projektligjin “Për Buxhetin e vitit 2020
3. Shqyrtimi i Projektligjit " Për buxhetin e vitit 2020” në parim

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Musa Ulqini, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Nikolin Staka, Edlira Hyseni, Kostaq Papa, Artemis Dralo dhe Ervis Meço

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Senida Mesi, Sadri Abazi.

E ftuar:

- Znj. Anila Denaj, Minister
- Znj. Mimoza Dhembli, Drejtor i Pergjithshem, Drejtoria e Buxhetit
- Z. Endrit Lami, Drejtor, Drejtoria e Politikave Makroekonomike
- Z. Nikolla Lera, Drejtor i Pergjithshem, Drejtoria e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

HAPET MBLEDHJA

Rudina Hajdari – Mirëdita, të nderuar kolegë!

Mirëdita, zonja Ministre!

Faleminderit që keni ardhur sot këtu!

E di që keni një axhendë shumë të ngjeshur, prandaj më vjen mirë që gjetët kohë për të ardhur në Komisionin e Integritetit, për të shqyrtuar projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Do të fillojmë me miratimin e procesverbalit të datës 5 nëntor. Kush është dakord? Besoj se jemi dakord të gjithë.

Gjithashtu, edhe për miratimin e kalendarit të punimeve të komisionit për periudhën 25 nëntor-20 dhjetor, të cilin e keni në tryezë. Besoj se jeni dakord edhe me këtë.

Pa humbur kohë, dua t’i jap fjalën zonjës ministre.

Faleminderit!

Anila Denaj – Faleminderit!

E nderuar, zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Më lejoni që ditën e sotme të bëj një prezantim të buxhetit në dy drejtime: së pari, në fokusin që ka komisioni dhe më pas në parametrat makro-ekonomikë fiskalë që parashikon projektbuxheti për vitin e ardhshëm.

Rritja ekonomike cilësore dhe e qëndrueshme, rritja e punësimit dhe përmirësimi i shërbimeve publike ndaj qytetarëve janë në fokus të vazhdueshëm të politikave të qeverisë dhe në vijim synojmë që edhe vitin që vjen të realizojë këtë objektiv. Paralelisht me këtë, kuadri makro-fiskal i kujdesshëm dhe realist, konsolidimi fiskal i vazhdueshëm, financat publike dhe stabiliteti financiar i qëndrueshëm janë objektiva sistematike të buxhetit, të cilat synohen të realizohen për të pestin vit radhazi edhe në vitin 2020.

Sektorët prioritarë në buxhetin e vitit 2020 janë: arsimi, shëndetësia, bujqësia dhe infrastruktura. Pak më vonë do të flas respektivisht për shumë shtesa në buxhet për secilin nga këta sektorë, të cilët synojnë jo vetëm rritjen e politikave, por edhe rritjen e cilësisë së shërbimit.

Në raport me veprimtarinë e këtij komisioni më lejoni të theksoj synimet tona në kuadër të plotësimit të kriterit politik dhe ekonomik të integritetit europian.

Për përmbushjen e standardeve të kriterit politik, do të doja të fokusohesha në dy momente të rëndësishme: reforma në drejtësi dhe reforma në administratën publike.

Së pari, do të flas për reformën në drejtësi.

Tani jemi në vitin e katërt të startimit të kësaj reforme madhore për Shqipërinë. Në projektbuxhetin e vitit 2020 pasqyrohen të gjitha kostot e nevojshme për funksionimin e të gjitha institucioneve të reja, të krijuara nga kjo reformë. Për vitin 2020 janë parashikuar kostot e plota të funksionimit të dy institucioneve të reja, respektivisht: Struktura e Posaçme Antikorrupsion, SPAK-u, me një kosto vjetore 381 milionë lekë dhe Inspektorati i Lartë i Drejtësisë, me një kosto vjetore 100 milionë lekë.

Nga viti 2016, kur u miratuan ndryshimet kushtetuese të lidhura me reformën në drejtësi, buxheti i shtetit ka përballuar një kosto vjetore të kësaj reforme, i cili, në vitin 2020 pritet të shkojë në 6 miliardë lekë. Kjo shifër e konsiderueshme tregon më së miri seriozitetin e angazhimit të qeverisë për të akomoduar të gjitha nevojat e strukturës si në infrastrukturë, edhe në personel.

Reforma në administratën publike dëshiroj të theksoj se është një prioritet kyç, një nga parakushtet për hapjen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Europian dhe një prioritet shumë i lartë për qeverinë shqiptare. Kjo reformë synon zhvillimin e një administrate publike në kuadër të zonës administrative europiane dhe në përputhje me të, siguron shërbime cilësore për qytetarët dhe për bizneset në mënyrë transparente, efektive dhe cilësore përmes përdorimit të teknologjive moderne të informacionit, shërbimeve inovative në përputhje me kriteret e integritetit evropian, si dhe ofrohet nga nëpunës civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, që janë pjesë e strukturave efikase të administratës publike. Në kuadër të modernizimit të sistemit të administratës publike, si dhe në përputhje me parimet kryesore të qeverisjes së mirë, mund të përmend se edhe gjatë vitit 2020 do të financohet me prioritet mirëfunksionimi i tri sistemeve të informacionit të menaxhimit, IPSIS, AFMIS dhe AMIS, të cilat kanë si qëllim planifikimin dhe monitorimin e integruar të politikave strategjike dhe menaxhimin e ndihmës financiare të huaj, përmes një sistemi të integruar për qeverisjen e mirë.

Vënia në eficiencë të plotë e këtyre sistemeve gjatë vitit 2020 do të lehtësojë së tepërmi procesin e vendimmarrjes politike dhe, njëkohësisht, do të rrisë transparencën. Nëpërmjet këtyre sistemeve do të bëhet e mundur që planifikimi të jetë më cilësor dhe të realizohet një ndryshim strukturor në nivel afatmesëm për të gjitha buxhetet e realizuara si në nivelin qendror, ashtu dhe në nivelin vendor.

Gjithashtu, në kuadër të transparencës dhe të vendimmarrjes politike do të vijojë financimi i sistemeve informatike dhe i strukturave koordinuese nëpërmjet ministrisë, çka do

të sigurojë konsultimin publik për projektaktet ligjore që do të ndërmerren nga këto institucione gjatë vitit 2020.

Organizimi dhe funksionimi i administratës publike në reformën e shërbimeve publike, po ashtu është një nga prioritetet kryesore të qeverisë shqiptare, i formatuar përmes një procesi radikal të riintegrit të mënyrës së ofrimit të shërbimit për qytetarët në një sistem gjithëpërfshirës qendror. Për këtë qëllim në vitin 2020, shërbimet e qendëruara të ofruara nga ADISA do të shtohen me dy qendra të tjera, me kosto përkatësisht rreth 21 milionë lekë për 30 punonjës shtesë. Në total, financimi për këto agjenci do të shkojë në rreth 375 milionë lekë, të cilat do të rriten gjatë viteve në vijim, si pasojë e mbulimit me shërbime të qendëruara për të gjithë popullatën, si një objektiv final.

Në aspekt me kriteret ekonomike, në raport me stabilitetin makro-ekonomik, dëshiroj të theksoj se projektbuxheti i vitit 2020 dhe njëkohësisht ai afatmesëm, 2020-2022, bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika makrofiskale do të vijojë të orientohej drejt konsolidimit fiskal për të vijuar trajektoren rënëse të borxhit publik ndaj produktit të brendshëm bruto. Kjo është thelbësore për të siguruar një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ekonomike. Rritja ekonomike parashikohet të jetë në nivelin 4,1% në vitin 2020 dhe 4,5% gjatë 3 vjetëve të ardhme, 2021-2022.

Premisat kryesore, mbi të cilat mbështetet ky parashikim, janë fundamentet kryesore ekonomike, të cilat kanë vijuar të përmirësohen, si: përmirësimi i vijueshëm i tregut të punës; perceptimi pozitiv i aktorëve ekonomikë për të ardhmen e ekonomisë; konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave publike; stabiliteti financiar; rritja e kreditimit në sektorin privat, si dhe qëndrueshmëria e pozicionit të jashtëm të ekonomisë.

Deficiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1,6% të produktit të brendshëm bruto. Ky përbën nivelin më të ulët të 10 vjetëve të fundit. Për të pestin vit radhazi balanca primare parashikohet të jetë sërish pozitive, në nivelin 0,7%, duke synuar mbajtjen e borxhit në trajektoren rënëse të tij. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritet të ulet në nivelin 62,2% të produktit të brendshëm bruto dhe do të vijojë më tej në parashikimet tona për të shkuar në nivelin 57% në vitin 2022.

Politikat fiskale në periudhat afatmesme do të jetë të orientuara drejt konsolidimit fiskal në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në ligjin organik të buxhetit. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik janë thelbësorë për reduktimin e risqeve makroekonomike, të cilat, nga ana tjetër, nëse ekzistojnë, pengojnë rritjen ekonomike dhe shkaktojnë paqëndrueshmëri makroekonomike. Vijueshmëria e performancës pozitive të tregut të punës do të vijojë edhe vitin që vjen. Tregu i punës regjistroi ulje të mëtejshme të

shkallës së papunësisë nën nivelin 12% këtë vit dhe synohet në nivelin 11% vitin e ardhshëm, duke siguruar rritjen e punësimit me 35 mijë vende të reja pune.

Në projektbuxhetin e vitit 2020 fondet për formimin profesional dhe nxitjen e punësimit do të synojnë aftësimin e më shumë punëkërkuesve të papunë dhe do të nxisin punësimin e tyre afatgjatë drejt tregjeve reale të punësimit. Ndërkohë, nëpërmjet mekanizmit të fondit për ndërmarrjet sociale do të bëhet e mundur të integrohen në tregun e punës edhe individët që vijnë nga skemat e ndihmës ekonomike dhe të aftësisë së kufizuar. Më lejoni të përmend që në këtë kuadër ligji i nxitjes së punësimit, i aprovuar në parlament në maj të këtij viti, do të jetë funksional përgjatë vitit që vjen, me të gjitha strukturat e tij dhe do të realizojë objektivat e vendosura për këtë qëllim.

Gjithashtu, projektbuxheti i vitit 2020 do të vijojë të ofrojë më shumë mbështetje financiare për fermerët ndërmjet skemave të menaxhuara në bashkëpunimin IPARD të BE-së, si dhe për bizneset e vogla dhe ato të mesme nëpërmjet skemave të ofruara nga AIDA.

Mbetemi të hapur për diskutime të mëtejshme në nevojë dhe në interes të deputetëve.

Ju falënderoj!

Rudina Hajdari - Faleminderit, zonja Ministre!

Unë kam disa pyetje për buxhetin për sa i përket procesit të integrimit, në përmbajtje, se si e kam parë unë buxhetin e vitit 2020, duke e krahasuar me buxhetin e viteve 2019 dhe 2018.

Në buxhetin tuaj keni cilësuar si prioritet kryesor hapjen e negociatave për vitin 2020. Për këtë pikë kam vënë re se ka pasur një ulje. Duke marrë parasysh se Ministria e Punëve të Jashtme është dikasteri koordinues i procesit të integrimit, vë re se tabela tregon që, nga viti 2019 në vitin 2020 ka një ulje të buxhetit, në një moment, kur Shqipërisë i rriten kriteret për t'u angazhuar më shumë për reformën në drejtësi dhe për reformën në administratën publike. Si i alokoni ju këto fonde? Si sigurohemi ne, si komision, që ju do t'i mbulonin këto dy procese dhe si do të alokohen këto përveç ministrisë? Ju mund të argumentoni se ky detyrim ndahet me disa ministri dhe është një bashkëveprim ndërsektorial, ndaj ky fond i koordinuar për Ministrinë e Jashtme është vetëm një pjesë e buxhetit në këtë pikë. A mund të më thoni si shpërndahet buxheti i shtetit për prioritetet që ne kemi për hapjen e negociatave? Dua të di cila pjesë e buxhetit tonë do të alokohet sot për reformën në drejtësi, për reformën në administratën publike, për luftën kundër korrupsionit, për luftën kundër krimit të organizuar dhe për forcimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Si e ndani ju buxhetin e shtetit për këto tema?

Faleminderit!

Anila Denaj – Hapja e negociatave është një objektiv i qeverisë dhe i gjithë popullit shqiptar për t'u realizuar. Synimi është që të gjitha reformat dhe proceset e nisura të finalizohen kundrejt afateve kohore të përcaktuara.

Në raport me Ministrinë e Jashtme, për buxhetin që përmendët ju, më lejoni t'i referohem faktit të 10-mujorit, faktit të vitit 2018, projeksionit të projektbuxhetit të vitit 2019, sikurse edhe projektbuxhetit të vitit 2020. Në shifrat që ne disponojmë nuk na rezulton të ketë ulje në total të buxhetit për ministrinë. Konkretisht, faktiku i vitit 2018 është 2,7 lekë në 10-mujor, ndërkohë që në vitin korrent është 2,5 miliardë lekë. I projektuar në aktin normativ është 3,1 miliardë lekë dhe projektbuxheti është 3,6 miliardë lekë. Në këto kushte, besoj se shumat janë të qarta. Së fundi ne kemi shtuar në projektbuxhet zëra në raport edhe me përfaqësimin tonë ndërkombëtar, duke besuar se shumat janë të mjaftueshme për të realizuar punën e Ministrisë së Jashtme në të gjithë dimensionin e saj.

Reforma në integrim nuk përfshin vetëm një ministri, por është e shpërndarë përgjatë gjithë ministrive. Më lejoni të theksoj se e gjithë ministria që unë përfaqësoj kanë embargo në disa procese të përshtatshmërisë së legjislacionit. Janë të paktën 14 kapituj që i drejtojmë vetëm ne. Pjesëmarrja në këto reforma është e gërshtuar me përshtatshmërinë e legjislacionit me legjislacionin e BE-së, një proces, i cili, në mënyrë të vazhdueshme, kërkon ekipe participuese në takimet e të dyja palëve.

Për të ndarë të gjithë këtë zë në aspekt me reformën do të na duhet të bëjmë disa përllogaritje për të hequr nga çdo ministri sesa është vlera dhe për ta vlerësuar këtë. Në raport me reformën në drejtësi është shumë e rëndësishme të themi çfarë kemi mbështetur këtë vit: 2,6 miliardë lekë janë vetëm strukturat e pagave që mbështesin institucionet e krijuara këtë vit. Vitin që vjen, përtej kësaj shume, kemi edhe 1,159 miliardë lekë shtesë, përveç 300 milionë lekëve në fondin rezervë prej 1,7 miliardë lekësh, që parashikohen vetëm për strukturën e pagave të reformës në drejtësi. Besoj se është angazhim në fonde në mënyrë të konsiderueshme për të mbështetur ngritjen e institucioneve në të gjitha elementet e tyre, ashtu edhe për procesin e integritetit në raport me Acquis BE në të gjithë kapitujt që janë nisur prej më se një viti.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Ministre!

Kush e do fjalën?

Po, zoti Balla.

Taulant Balla – Nëse buxheti i vitit 2020 do të duhet të kishte një emër, unë mendoj që padyshim ky është buxheti i konsolidimit të reformave në funksion të përmbushjes së aspiratës historike të Shqipërisë për anëtarësim në Bashkimin Europian. Pra, ky është buxheti

i fillimit të bisedimeve për anëtarësim. Dua të bashkëndaj me ministren disa prej çështjeve kryesore që kanë të bëjnë me këtë komision.

Së pari, qeveria shqiptare tregon angazhim të plotë në mbështetje të implementimit të reformës në drejtësi. Të gjitha institucionet e reja të krijuara pas ndryshimeve kushtetuese dhe paketës së reformës në drejtësi vijnë të mbështeten fuqimisht nga buxheti i shtetit, duke marrë kështu një mbështetje të konsiderueshme buxhetore. Ajo që u tha nga kryetarja e Komisionit të Integritetit për mbështetjen e forcimit të kapaciteteve në administratën publike me qëllim përgatitjen e kapaciteteve tona negociuese është adresuar më së miri në buxhetin e shtetit.

Komisionet e tjera vijnë punën për vlerësimin e planifikimit të investimeve publike në sektorët prioritarë. Për Komisionin e Integritetit prioritet është procesi i integritetit europian. Mendoj që fillimi i bisedimeve për anëtarësim gjatë vitit 2020 është një çështje që do të adresohet gjatë presidencës kroate në gjashtëmujorin e parë të vitit 2020. Unë gjithmonë jam shpresëplotë që çështje të karakterit të brendshëm mes vendeve anëtare të Bashkimit Europian për mekanizmin e monitorimit të vendeve aspirante do të zgjidhen dhe Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut, të cilat e meritojnë plotësisht fillimin e bisedimeve për anëtarësim, do të marrin lajmin e mirë për ta filluar këtë proces.

Si deputet i një zone të caktuar, dua të shpreh këtu (kjo nuk është çështje e komisionit tonë, por e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave) rëndësinë për t'i qëndruar strikt angazhimit që kemi në ligj për 1- përqindëshin në funksion të GDP-së, që t'u shkojë si transfertë e pakushtëzuar bashkive të vendit. Kam parë që kjo çështje nuk është ashtu siç e përcakton ligji, megjithatë është një çështje që duhet ta adresoni në komision. Nuk është një çështje për diskutim në Komisionin e Ekonomisë. Bashkitë e vogla, kryesisht bashkitë e nivelit të dytë dhe të tretë, duhet të kenë më shumë vëmendje nga ana e buxhetit të shtetit, sepse parimi i transfertës së pakushtëzuar është pikërisht asistimi i bashkive me të ardhura më të vogla, me qëllim përmbushjen e aktivitetit të tyre në shërbim të njerëzve. Vëmendja jonë për njerëzit është dhe duhet të jetë e njëtrajtshme në të gjithë territorin e Republikës. Njësoj siç përfitojnë qytetarët shërbime publike këtu në qendër të Tiranës, të njëjtat shërbime publike duhet t'i përfitojnë në të gjithë territorin.

Për të mos u zgjatur, mendoj që ky buxhet ka konsoliduar më së miri financat e vendit, ritmet e rritjes ekonomike, si dhe rrugën europiane të Shqipërisë. Për Komisionin e Integritetit Europian këto janë tri çështjet thelbësore që duhen vënë në dukje në relacionin që bashkëshoqëron buxhetin.

Është pjesë e demokracisë që shumica e mbështet buxhetin, kurse opozita gjithmonë e kundërshton buxhetin (kjo është praktikë që kur është shpikur kjo lloj forme e funksionimit të shteteve dhe parlamenteve), por kur bie fjala për çështje që na kanë bashkuar gjithmonë, maxhorancën dhe opozitën, çështje të integritetit europian apo çështje të mbështetjes së reformës në drejtësi, mendoj që ky është rasti që ky buxhet e ka kryer këtë detyrë më së miri.

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zonja ministre.

Më pas do të kalojmë në pyetje të tjera ose komente.

Anila Denaj – Dua të bëj një sqarim në raport me komentin e zotit Balla për sa i takon fondit të pakushtëzuar.

Në fakt, në mënyrë të dukshme edhe nga shifrat, është e qartë që fondi i pakushtëzuar 18 milionë lekë është 1-përqindëshi mbi totalin. Nëse i bëhet referencë shpërndarjes, kjo është në bazë të një formule, e cila nëse duhet riparë për të rialokuar për bashki të caktuara sipas prioriteteve, është një element tjetër.

Rudina Hajdari – Zonja Ministre, më fal që ju ndërpres, por meqë kjo çështje nuk fokusohet në procesin e integritetit, nuk besoj se i intereson pjesës tjetër të anëtarëve të Komisionit të Integritetit. Kontaktet me zotin Balla i keni, kështu që mund ta sqaroni në një moment tjetër për këtë çështje.

Kush e do fjalën për pyetje apo për komente?

Ke koment apo pyetje?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse më lejohet, kam një koment për atë që ju thatë për buxhetin e vitit 2020 për procesin e integritetit. Ju theksuat në fjalën tuaj që janë dy kritere kryesore: kriteri politik dhe kriteri ekonomik.

Ajo që vura re në kriterin politik (patjetër që reforma në drejtësi është prioritare dhe një objektiv madhor për vendin) është që ndoshta fokusi ka qenë mbi këtë reformë më shumë sesa te reformat e tjera dhe nuk përmendët pikat e tjera për sa i përket procesit apo kriterit politik që ne duhet të çojmë përpara në mënyrë që të hapen negociatat. E kam fjalën këtu për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Nuk jam e qartë. Duke marrë parasysh që kriteri politik është shumë i rëndësishëm për integrimin tonë europian, si llogariten këto të ardhura në buxhetin e shtetit në mënyrë që kriteri politik në vitin 2020 t'i arrijë objektivat që ne të bindim vendet anëtare se po luftojmë në këto dy fusha tepër të rëndësishme për hapjen e

negociatave, sidomos në këto momente shumë kritike kur nuk dimë çfarë do të ndodhë me procesin e integritit europian?

Bundestagu gjerman shtoi kriteret. Ju thatë që në këtë buxhet nuk ka ulje, por ndërkohë nuk është cilësuar si përparësi e qeverisë tonë. Ndoshta e përmendët nga fundi këtë gjë, por nuk e përmendët në fjalën tuaj që integriti europian duhet të jetë kryefjala e kryefjalës e çdo qeverie, por edhe e kësaj qeverie për vitin 2020, e cila duket sikur çdo vit nuk po i kushton vëmendje procesit të integritit dhe çdo vit po shtohen kriteret për hapjen e negociatave.

Për sa i përket kriterit ekonomik, ju thatë që ka pasur ulje të papunësisë. Po ashtu ju thatë që do të ketë një ulje të borxhit publik. Ju lutem, mund të na thoni si i përllogarisni ju këto shifra, ndërkohë që ne jetojmë në një realitet ku shumica e popullsisë po largohet? Në buxhet ju thoni që kemi një popullsi prej 2,9 milionë banorësh, por ne nuk e dimë akoma nëse kjo shifër është e vërtetë, sepse nuk kemi bërë censusin për ta ditur se deri ku kanë shkuar shifrat. Si e llogarisni ju dhe në cilin sektor e llogarisni ju këtë ulje të papunësisë?

E dyta, si e përllogarisni ju borxhin publik, sidomos pas kritikës që na ka bërë FMN-ja për partneritetin publik-privat? Pra, e llogarisni këtë në borxhin publik? Janë disa shifra që unë mendoj se nuk janë shumë realiste, ndaj do të doja një përgjigje konkrete. Mendoj që janë dy kritere shumë të rëndësishme për hapjen e negociatave dhe ne duhet të jemi sa më realistë me veten tonë, por edhe me qytetarët në lidhje me këto dy pika.

Faleminderit!

Anila Denaj – Unë jam besimplotë që çdo ministri, e cila ka një zë më të theksuar në proceset e saj për reformën e integritit europian, do të shkoj në të gjitha detajet e zërave të saj buxhetore se si këto zëra do të mbështesin çdo fazë të integritit europian. Integriti europian nuk është detyrë e një ministrie, por e të gjitha ministrive të përfshira në një proces, i cili, siç e thashë pak më parë, ka të bëjë me përshtatshmërinë e legjislacionit, fokusin dhe luftën ndaj korrupsionit dhe përmirësimin e të gjithë raportit në lidhje me shërbimet publike, të cilat jo pak ulin dhe do të ulin në të ardhmen edhe këtë element korrupsioni, pasi teknologjia e informacionit do të zëvendësojë marrëdhënien e drejtpërdrejtë të njerëzve, duke ulur edhe kontaktin mes tyre për të mundësuar edhe më tej transparencë, shërbime në kohë optimale dhe kontroll mbi këto komunikime.

Për sa i takon pjesës së Ministrisë së Drejtësisë, fokusi në fjalën time ishte tek institucionet pasi këtu është edhe zëri kryesor i shtesës që i bëhet një ministrie jo pak të rëndësishme në këtë proces për të luftuar dhe për të mbështetur një reformë kaq të rëndësishme si integriti europian. Ky ishte fokusi i vendosur në fjalën time, por jo për të

nënvlerësuar të gjithë procesin e integritetit europian, pasi, siç e thashë më parë, ai është i prerë në të gjitha linjat e ministrisë, duke filluar nga ministria që unë drejtoj për kapitujt që ju thashë, te lufta nëpërmjet institucioneve të pavarura si Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimi të Pastrimit të Parave e të tjera.

Më lejoni të them që parlamenti i nderuar ka aprovuar këtë vit mjaftueshëm ligje për të ndihmuar këto reforma edhe nëpërmjet paketës “Manyval”, që është jo pak e rëndësishme për ta theksuar këtë vit. Pa qenë nevoja për ta kuantifikuar si kosto, sepse ajo është brenda të njëjtës strukturë kosto për strukturë personeli, vetëm aplikimi i pesë ligjeve brenda paketës “Manyval” do të na mundësonte një luftë më të madhe drejt parandalimit të pastrimit të parave. Jo gjithmonë është në vlera monetare nëpërmjet rritjes së pagave, mund të jetë edhe brenda të njëjtës strukturë, por me ligje të përmirësuara, të cilët tregojnë angazhim dhe të njëjtin proces konsolidimi siç do të duhet të ndodhnim brenda kushteve, qoftë të Bundestagut apo të vetë qeverisë shqiptare ndaj vetvetes, për të arritur një përmirësim të dukshëm të procesit.

Lufta ndaj korrupsionit drejtohet nga të gjithë ministrat, por në veçanti nga ministrja e Drejtësisë. Kërkoj që të gjitha masat e marra t’ia adresoni ministres. Nëse është e nevojshme ta shikojmë nga ana jonë, sigurisht që ne do të kthehemi, do të marrim të gjithë informacionin që i takon vetëm kësaj fushe dhe do t’i kthejmë përgjigjen respektive komisionit.

Për sa i përket elementit makrofiskal, borxhit publik dhe deficitit buxhetor, ulja e tyre sot është e prekshme. Ne nuk e filluam sot uljen e deficitit buxhetor dhe borxhit. Kjo është një mënyrë më e mirë e menaxhimit të financave publike, duke miradministruar burimet dhe duke paguar edhe detyrimet tona të marra hua. Sigurisht, kjo ka një kosto. Jemi të ndërgjegjshëm që një kuadër fiskal i qëndrueshëm do të ketë një kosto ndaj investimeve, por ne duhet të vendosim si të shikojmë drejt një qëndrueshmërie afatgjatë. Në këtë aspekt, është shumë e rëndësishme të shikojmë që ulja dhe reduktimi i borxhit është prioritet.

Nëse diskutimi i shpeshpërfolur për adresimin e disa kostove, siç janë kostot PPP të kontratave koncensionare, është apo jo borxh, më lejoni të theksoj... E kam adresuar dje në Komisionin e Ekonomisë, kur kemi diskutuar në detaje, argumentin pse nuk e kemi të deklaruar tek elementi i borxhit, përtej diskutimeve, që i bëjmë me FMN-në dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat, edhe kur e publikojnë raportin e tyre, e bëjnë evidencë raportin e borxhit përfshirë apo jo këto detyrime, pasi sipas standardeve ESA 95, për hir të vetë metodologjisë së përlllogaritur në këto standarde, prej vitit 2016, kur janë vendosur, janë klasifikuar si një instrument që vendoset jashtë deklarimit.

E rëndësishme është të themi nëse këto informacione, që kanë të bëjnë me PPP-të, janë apo jo publike.

Në të dyja aspektet, si në aspektin e kontratave individuale, që menaxhohen në mënyrë administrative nga një agjenci brenda Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, si Atraco, e cila çdo kontratë koncensionare ka obligimin për ta publikuar, ashtu edhe në një proces në të cilin ne kemi embarguar prej 1 tetorit me ndryshimin që i është bërë ligjit për menaxhimin e kontratave koncensionare, ku roli i Ministrisë së Financave është më i shtuar dhe në këtë rol monitorues po mbështetemi nga Banka Botërore.

Ne kemi finalizuar para disa ditësh një raport të të gjitha kontratave koncensionare, i cili në momentin kur mbaron gjithë procesin e editimit, do të jetë publik për të gjitha palët. Kjo është një mënyrë për të rritur transparencën për të gjitha kontratat koncensionare, të cilat sot, brenda kufizimeve që jep ligji organik i buxhetit, janë në 3,3 % të tavanit 5% të vendosur mbi totalin e të ardhurave të një viti paraardhës.

Më lejoni t'ju themi se tavanin prej 5% është përsëri një obligim ligjor, i cili nuk është prekur në nivelin e tij limit. Ne synojmë që, gjithsesi, ta mbajmë nën kontroll për PPP-të dhe për zhvillimin tyre vitet e ardhshme. Projektionet tona për PPP-të zhvillohen deri në efektin e tyre ndaj këtij treguesi deri në vitin 2032, i cili shkon në trend rënës pas dy vjetëve në vijim.

Nëse kam lënë diçka pa përmendur, të lutem, më ndje! Mund ta shohim edhe me kolegët e mi.

Rudina Hajdari – Fjala për zotin Gjoni.

Ralf Gjoni – Zonja Ministre, ju falënderoj për prezantimin e projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”!

Në fakt, kam një koment për buxhetin e shtetit dhe më pas një pyetje më specifike për këtë projektligj.

Me çfarë shoh nga buxheti i vitit 2020, ky nuk është një buxhet që u shërben qytetarëve shqiptarë, por koncesioneve.

Nuk do të ketë rritje të pagave për administratën publike (më korrigjoni nëse e kam gabim), madje as indeksim 2%.

Nuk ka rritje të pensioneve, por vetëm indeksim të pensioneve.

Nuk ka investime publike të kënaqshme për shkollat, spitalet e veprat publike.

Në krahasim me vitin 2019 këto shpenzime, me sa kuptoj nga buxheti, për vitin e ardhshëm janë më të ulëta.

Praktikisht, me ç'shoh, pothuajse çdo zë i buxhetit, që çon lekë te qytetarët, ose ka mbetur në vend numëro, ose është ulur me justifikimin e përhershëm të çdo qeverie, sidomos

të qeverisë suaj, se nuk ka lekë. Ndërkohë, afërsisht 120 milionë euro do të jepen në 2020-n për koncesionet.

Tani, si i shërben qëndrimi në vend numëro për pagat e administratës publike dhe veprat publike përgatitjes së Shqipërisë për integrimin europian?

Pra, administratës, që duhet të jetë tërësisht e angazhuar për adresimin e kapitujve (nëse ato do të hapen, se nuk kemi asnjë lloj sigurie që do të hapen në vitin 2020, por le të ëndërrojmë që brenda vitit 2020 do të ketë një hapje parciale të kapitujve për negociim), duhet t'i rrisni pagat, sepse e dimë që jo vetëm kemi mungesë kapacitetesh profesionale, por kemi edhe pagesa shumë të ulëta, sidomos për specialistët, që do të merren me procesin e integritetit europian.

Më shqetëson fakti që qeveria shqiptare nuk i kushton aspak vëmendje rritjes së buxhetit të pagave, që rrjedhimisht rrit edhe mundësinë thithëse të kapaciteteve edhe më profesionale brenda administratës publike, për të shërbyer në kuadër të procesit të integritetit europian.

Kuptohet, do të kemi mundësi edhe në komisione të tjera, por edhe në parlament, të bisedojmë për buxhetin, sepse me sa shoh po përsëritet e njëjta histori. Sa herë që vjen puna te buxheti (kjo nuk ka lidhje me ju personalisht) provokohet një skandal tjetër mediatik dhe të gjithë merren me skandalin, me fabulën jashtë dhe shumë pak merren me buxhetin e shtetit, që për mua është bërthama kryesore e diskutimeve në parlament për këtë vit.

Për projektligjin në fjalë, për shkëmbimin automatik të informacioneve të llogarive financiare, kam një pyetje: si mendoni ju se garantohet konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale në përputhje me legjislacionin kombëtar në fuqi? Sepse vërtet ju flisni për anëtarësinë e Republikës së Shqipërisë pranë forumit global... Që ta kem emërtimin e saktë... Nejse, ju e dini se për çfarë e kam fjalën. Forumi global përbëhet 150 e ca anëtarë. Tani, në këtë forum global për shkëmbimin e të dhënave bën pjesë edhe Britania e Madhe dhe Franca, dy vende që i njoh dhe janë shumë të ndjeshme ndaj shkëmbimit të të dhënave personale dhe mbrojtjes së konfidencialitetit të qytetarëve të tyre.

Si mendoni ju dhe çfarë garancish jepni që do të ruhen të dhënat personale dhe do të mbrohet konfidencialiteti përmes këtij projektligji?

Faleminderit!

Anila Denaj – Më lejon të kthehem te buxheti. Pastaj për pjesën e pyetjes në raport me shkëmbimin, unë jam e kënaqur që e keni si pikë të dytë të agjendës, sepse konfirmon edhe një herë punën që po bën qeveria shqiptare dhe ministria që unë përfaqësoj në raport me

rritjen e kapaciteteve legislative për të mbështetur më mirë të gjitha praktikat ndërkombëtare, si ato të MONEYVAL-it dhe OECD-së, siç është rasti konkret.

Sigurisht, kjo do të ndihmojë në gjithë luftën ndaj evazionit, korrupsionit e të tjerë në mënyrë akoma më të strukturuar dhe brenda një ombrelle europiane.

Për t'u kthyer te buxheti, në qasjen si ministre e Financave dhe Ekonomisë, kur flitet për një buxhet, shikohen të gjitha dimensionet dhe nevojat. Nëse flitet se ky është një buxhet i PPP-ve, unë do të thosha se këtë vit në gjithë shumën *outstanding* pagesat që duhet të bëhen janë të të gjitha shërbimeve, që cilat rrisin cilësinë, siç janë ato të lidhura me shëndetësinë, apo rrisin infrastrukturën, siç janë ato të lidhura me infrastrukturën. Nuk shoh të kalimi dhe tejkalimi mbi një tavan të jetë një problem juridik apo buxhetor, sepse e thashë edhe pak më parë, është në 3,3% të tavanit.

Ndërkohë, shkëputur nga konteksti PPP-ve, por lidhur me rishpërndarjen e të ardhurave, është e vërtetë që ne jemi treguar (nuk do të thosha optimistë) realistë në raport me të ardhurat e vitit tjetër, sidomos me të ardhurat e siguruara nga administrata tatimore dhe doganore, me një total prej 29 miliardë lekësh (këto nuk i vendosa në prezantimin tim, se mbase nuk ishte e nevojshme të shkonim në detaje, por më lejoni t'jua them) krahasuar me 20 miliardë lekë, që është parashikuar ky vit, në 2018-n.

Pra, po të flasim për rritje totale të ardhurash, mendojmë se kjo rritje është realiste për të mundësuar të mos kemi rishikime me efekt të kundërt, por të kemi mundësi që ato që premtojmë t'i mbajmë.

Të mos harrojmë se efekti i këtij viti në uljen e parashikueshmërisë vjen në mënyrë të diktuar edhe nga ndikimi që ka në rritjen ekonomike, dhe që ka pasur këtë vit në veçanti, sektori energjetik.

Në sektorin e energjetik, varësia që kemi ndaj produktit të energjisë së prodhuar nëpërmjet burimeve tona hidrike është një proces që Ministria e Energjetikës dhe Infrastrukturës po e adreson nëpërmjet një politike, e cila zgjeron dhe diversifikon shfrytëzimin e burimeve tona natyrore, duke përfshirë edhe ato solare.

Sigurisht, të gjitha këto politika do të çojnë drejt zgjerimit të alternativave në investime dhe në thithjen e investimeve të huaja, por njëkohësisht edhe në uljen e varësisë nga hidrikja, në mënyrë që edhe ky ndikim, vetëm në 6- mujorin e parë me 1 pikë përqindje në rritjen ekonomike, të reduktohet në vitet në vijim dhe ato industri, të cilat edhe në 6- mujorin e parë të këtij viti, siç janë industria nxjerrëse e të tjerë, kanë rritur me 15 % ritmin e tyre nga një vit në tjetrin, të ndikojnë edhe në strukturën e rritjes ekonomike në të ardhmen.

Arsimi, shëndetësia dhe bujqësia janë sektorët prioritarë, që në 2020-n vijnë të marrin (përtej drejtësisë, që unë e përmenda pak më parë për gjithë nevojën për të akomoduar institucionet e reformës në drejtësi), vëmendjen më të madhe, respektivisht 3,3 miliardë lekë arsimi, 2,75 miliardë lekë shëndetësia dhe 1,8 miliardë lekë bujqësia.

Këto shtesa do të shkojnë te qytetarët dhe ne duhet ta themi këtë, sepse janë reforma, që mundësojnë Ministrinë e Arsimit të ndihmojë Paktin e Universitetit, për të vijuar edhe për të dytin vit radhazi me një shtesë prej gati 2 miliardë lekësh apo arsimin parashkollor nëpërmjet një ndryshimi metodologjie, që do të ndihmojë të ketë më shumë edukatorë, sepse nuk duhet të jetë më standardi “kam kaq edukatorë dhe do t’i shpërndaj”, por “kam kaq nxënës dhe do të më duhen më shumë edukatorë”. Janë të paktën 440 edukatorë më shumë shtesë në total bashkë që do t’i shtohen cilësisë.

Të mos harrojmë që për rrezikun nga përmytjet, 1 miliard lekë, që do të investohen në buxhetin e Ministrisë së Bujqësisë për të përmirësuar parandalimin e përmytjeve nga digat, janë investime në infrastrukturë, që do të përmirësojnë edhe rreze të mundshme nesër, që të mos reagojmë me fond emergjencash, por me fonde investimesh para.

Të mbetemi vetëm te rritja e pagave nuk është e drejtë, për ta thënë siç duhet, te shpërndarja e të ardhurave shtesë për vitin tjetër.

Në qoftë se kthehem te rritja e pagave, që ju e përmendët si një nga ngërçet kryesore të këtij buxheti, më lejoni t’ju them se këtë vit rritja e pagave në 4 sektorë ndikoi me 2 miliardë lekë në vitin 2019, për një periudhë që filloi nga 1 prilli deri në fund të vitit. Kuptohet, për vitin tjetër ky efekt do të vijojë dhe i zgjeruar për gjithë vitin është 3 miliardë lekë.

Në gjykimin financiar, për pagat duhet pasur vëmendja te sektorët prioritarë dhe nuk mund të ndodhë çdo vit ndryshimi i pagave për çdo sektor. Ajo duhet të rishpërndahet, por nuk mund të bëhet pa u shoqëruar me reforma për të gjithë sektorët. Ka sektorë që janë akoma duke parë nëse strukturat janë efektive.

Ne po flasim për rritje të informacionit të teknologjisë. Ajo që ndodh është se kur ka sisteme të reja informatike, nuk shihet vetëm shërbimi, por duhen parë edhe strukturat. Para se të rrisim vetëm rrogat, të cilat do të kenë një kosto nesër, ne duhet të shikojmë edhe strukturat, nëse janë efektive. Po themi, ADISA, po flasim për unifikim shërbimi, atëherë, do të qëndrojmë me të njëjtën strukturë apo do t’i rrisim rrogat dhe pastaj kur të kemi nevojë të ulim dhe të riorganizojmë strukturat dhe klasifikimet e tyre, të na kthehet në një kosto? Këto janë procese, që duhet të shkojnë paralelisht.

(Ndërrhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari - Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni - Unë ju bëra një pyetje shumë të thjeshtë: që kur jeni bërë Ministre, a jeni në dijeni që administrata shqiptare është e keqpaguar në krahasim edhe me vendet fqinje?

A jeni në dijeni që një administratë e keqpaguar, e keqtrajtuar financiarisht nga qeveria e saj, nuk ka mundësi të thithë kapacitete profesionale? Pra, e thënë troç: një person i kualifikuar me një diplomë të marrë jashtë nuk ka asnjë interes të vijë dhe të punojë në administratën shqiptare për t'u angazhuar gjatë procesit të negociatave. Më fal, por kush do të negociojë në qoftë se hapen negociatat?

A jeni në dijeni që Ministra e Jashtme nuk ka kapacitetet e nevojshme për të negociuar? Jeni në dijeni që Ministria e Drejtësisë ka kapacitete shumë të dobëta për të negociuar, për të hartuar legjislacion dhe për të negociuar me strukturat e Bashkimit European? Si mund t'i thithim ne profesionistët e shkolluar jashtë, që kanë eksperiencë edhe në strukturat e Bashkimit European, me rroga kaq të ulëta? Pyetja ime është shumë e thjeshtë. Unë nuk kam nevojë të dëgjoj sot në Komisionin e Integritetit për strukturat kulluese të zonave të përmbytura të bujqësisë. Ju bëra një pyetje shumë të thjeshtë: pse qeveria shqiptare këtë vit ka vendosur të mos rrisë pagat e administratës publike për vitin tjetër? Pyetja është shumë e thjeshtë dhe dua një përgjigje shumë të thjeshtë.

Anila Denaj – Ju lutem, para se të jap një përgjigje, mund të më thoni konkretisht, me shifra, ku janë vendet që nuk kanë arritur të përthithin në administratën publike persona të kualifikuar, sepse këtë raport ne duhet ta vendosim me shifra konkrete. Unë konkretisht, në ministrinë që përfaqësoj, kam vende vakante, për të cilat po aplikojnë edhe personat që kanë studiuar jashtë. Do të japim shifra dhe do të ballafaqojmë të dyja palët. Sigurisht, sepse ne nuk mund të bëjmë vetëm një fushatë mediatike. Ne duhet të marrim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Kam Drejtorinë e Huamarrjes. E dini çfarë ndodh? Duhet disa muaj që të plotësohet kuadri i adaptimit të diplomës. Kjo nuk ka të bëjë me përthithjen, por me disa procese, të cilat duhet të marrin kohën e duhur. Unë kam të paktën 3 vende në Drejtorinë e Menaxhimit të Borxhit dhe në drejtori të tjera, për të cilat aplikantët kanë studiuar jashtë dhe nuk mund të aplikojnë, sepse brenda kuadrit rregullator të saktë, duhet të aplikojnë për të përshtatur diplomën. Nuk më konstaton në ministrinë që drejtoj, dhe e kam konkretisht, të paktën edhe nga përthithja që po përpiqem t'i bëj, të vërtetoj atë që thoni ju.

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme unë do të informohem te DAP-i nëse ka vende që ata nuk po i përthithin dot.

Megjithatë, pyetja juaj ishte ...

Ralf Gjoni – Pyetja ishte shumë e thjeshtë: pse nuk janë rritur rrogat për administratën publike?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

A jeni në gjendje të thoni se nuk ka lekë mjaftueshëm në buxhet?

Anila Denaj – Më falni!

Pse nuk e vlerësoni rritjen e këtij viti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë e përmenda në fjalinë time. Ka procese që, para se të rrisim rrogat, duhet të shikojmë reformën. Reforma është po aq e rëndësishme.

Ralf Gjoni – Zonja Ministre, ju lutem!

Ju kërkoi ndjesë!

Nuk e di nëse e keni kuptuar ende, por kur ekzekutivi vjen në parlament, vjen për të dhënë llogari. Ne jemi sovrani, ju jeni ekzekutivi, për të qartësuar rolet. Si në Shtetet e Bashkuara, si në Britaninë e Madhe, parlamenti ka të drejtë t'i kërkojë llogari ekzekutivit dhe ta fusë në zgarë kur vjen puna te buxheti. Pra, është detyra jonë. Unë e kam me ju personalisht, por profesionalisht. Ne na duhen përgjigje të thjeshta dhe të qarta. Unë ju bëra një pyetje të thjeshtë dhe dua përgjigje, nuk dua propagandë. Propagandën le ta bëjë zoti Balla, sepse e qan atë punë në Partinë Socialiste. Unë ju bëra një pyetje të thjeshtë: pse nuk janë rritur pagat e administratës publike për vitin që vjen? Dua një përgjigje të thjeshtë, jo propagandë.

Faleminderit!

Anila Denaj – Unë do të doja që, me gjithë respektin, dhe faktin që unë e marr shumë seriozisht dhënien e përgjigjeve, të cilën e thashë edhe pak më parë, përgjigjja ime në raport me rritjen e pagave u tha. E përsëris: pagat janë rritur këtë vit. Pagat nuk mund të rriten çdo vit pa analizuar se çfarë strukturash, çfarë klasifikimesh dhe çfarë kostosh të tjera shtesë do të ketë çdo rritje page. Nëse ne flasim për rritje të pagave, nga çdo ministri duhet të vijë argumenti pse duhet kjo rritje page? Pse pas rritjes së teknologjisë së informacionit unë duhet të rris sërish pagat, kur, me të njëjtën strukturë, sigurisht, mund të rris efektivitetin? Nëse kjo kursehet nga rritja e sigurisë dhe e marrjes së një informacioni në kohë reale, ai informacion të shkojë... Nuk mund të ndodhë çdo vit rritje pagash. Nuk besoj se kjo është e vendosur në një ligj, por shkon me logjikë, që të mos prodhojë kosto pas disa vitesh. Për këtë, si ministre Financave, unë ruaj parametrat fiskalë, sikurse, si ministri, jo vetëm si ministre, nuk mendoj se kam eliminuar rritjen e pagave, sepse edhe institucionet e drejtësisë nuk janë të

parëndësishme, për t'i konsideruar si një rritje e konsiderueshme pagash. Për vitin që po flasim, plus vitin që vjen, janë 3,3 miliardë lekë më shumë. Kjo është rritje pagash, pavarësisht se kontribuon në një sektor, apo në një sektor tjetër.

Rudina Hajdari – Po, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit!

Në fakt, nuk kam pyetje të drejtpërdrejtë, por më provokon reagimi i kolegut. Ministria e shpjegon shumë më mirë sesa unë, sepse është e profesionit, por nuk e di si mund të trajtohet çështja e buxhetit si një gjë kaq e thjeshtë, për të thënë pyetja është shumë e thjeshtë, ndërkohë që, në fakt, buxheti është një ekuacion me të gjitha të panjohurat e mundshme dhe me detyrën për t'u dhënë përgjigje të gjithave.

Një nga argumentet, që ministria sapo e dha, ka të bëjë me reformën në drejtësi, në të cilën kemi një shtesë të fondit të pagave dhe të vendeve të punës. Kjo e çon ujin në mullirin e rritjes së pagave. Unë do ta ndalja te shtesa prej 10% krahasuar me vitin 2018 në një sektor që më duket shumë më i rëndësishëm sesa rritja e rrogave të administratës, duke përfshirë brenda të gjithë punonjësit e administratës, këtë e them edhe si ish-drejtuese e një ministrie që ka punuar me administratën, që ka të bëjë me rritjen e shtimit të fondit të pagave për edukatorët. Çdo buxhet bëhet me prioritete. Nëse i jepet prioritet pikërisht sektorit të edukimit në parashkollor, që do të jetë, në fakt, determinant për arsimin parauniversitar e më tutje, mua më duket prioritet me vend dhe dua të falënderoj zonjën ministre që e ka vendosur këtë prioritet për ta realizuar në vitin 2020.

Në fund, do të thosha se ky argument nuk ka të bëjë me komisionin tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Ne jemi këtu për të parë sa përputhet ky buxhet me prioritet tona për integrimin europian. Reforma në drejtësi më duket se është prioritet mbi prioritetet tona, yni dhe i partnerëve. Në momentin që ky buxhet i përgjigjet këtij prioriteti, mendo se ne kemi përmbushur një nga gjërat më të rëndësishme, që ka të bëjë me integrimin europian. Me këtë besoj se merr përgjigje. Nëse kolegët e tjerë nuk kanë gjë, ndjesë që po marr rolin e kryetares, por do të sugjeroja të ecnim përpara me çështjet e tjera.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Kumbaro!

Për atë që sapo thatë, besoj se ju e kuptoni fare mirë që reforma në drejtësi nuk është pika e vetme që kemi si kriter. Patjetër që ne duhet t'i trajtojmë të gjitha temat që kanë të bëjnë me procesin e integritetit. Meqë jemi në këtë pikë, kisha edhe një pyetje të fundit, të

cilën nuk e trajtova në fjalën time, që ka të bëjë me çështjen e pronave, që është në kuadër të forcimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Zonja Ministre, çfarë është parashikuar në buxhetin e vitit 2020 për kompensimin e pronave dhe për kompensimin e të përndjekurve politikë? Shikoj që në buxhet ka një rënie, por do të doja një sqarim nga ju për çështjen e pronave: si e keni trajtuar ju në këtë projektbuxhet?

Faleminderit!

Anila Denaj – Unë do t’u thosha edhe kolegëve të mi që tabelat e nisura të jenë të sakta për të dyja palët, se ndoshta mund të jeni me një plan ku krahasimi ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E vura re edhe tek e para...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, është e vërtetë.

Në raport me buxhetin, i cili nuk është i pritshëm. Buxheti i pritshëm, të cilit ne i bëjmë referencë, është ai që parashikojmë në fund të vitit. Në këtë aspekt, kjo është një tërheqje vëmendjeje jona, dhe ju kërkujmë ndjesë, në mënyrë që të gjitha tabelat krahasuese që ne kemi, si e para, që përmenda pak më parë, të mos na vënë në pozita, me qëllim që të krijojmë një informacion të plotë.

Në rastin e pronave, në krahasim me të pritshmin, më lejoni të them çfarë është i pritshmi dhe pse do të jetë i ndryshëm. Të ardhurat totale në raport me të ardhurat e realizuara nga tatimet dhe doganat parashikohen të jenë në minus (është trajtuar gjerësisht në Komisionin e Ekonomisë dhe unë jam e gatshme t’i vë në dispozicion komisionit arsyet e minusit), i cili nuk do të prekë asnjë parametër fiskal. Ne e kemi thënë edhe në komisionet e tjera që ky është një minus i parashikuar të ndodh në nivelin 13 miliardë lekë në krahasim me fillimin e vitit. Parametrat që do të preken do të jenë ata që gjatë vitit janë krijuar si rezerva për të eliminuar risqe edhe të mosrealizimit, si dhe disa elemente të tjera, siç ishin të parashikuar te projeksioni. Pjesa e fondit të pronat është 4,5 miliardë lekë, pra, 500 milionë lekë më shumë se i pritshmi i 2019-ës.

Rudina Hajdari – Më falni, mund ta përsërisni fjalinë e fundit?

Anila Denaj – Fondi për vitin 2020 është 4,5 miliardë lekë dhe është 500 milionë lekë më shumë se i pritshmi i vitit 2019.

Rudina Hajdari – Të nderuar kolegë, nëse nuk ka më pyetje apo komente, e mbyllim këtu mbledhjen e ditës së sotme.

E votojmë në parim projektligjin “Për buxhetin e vitit 2020”.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Faleminderit, zonja Ministre për prezencën në komision!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kemi edhe projektligjin tjetër, por kam përshtypjen se kishim të ftuar të tjerë. Meqë ju jeni këtu mund ta ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund ta shqyrtojmë me zonjën ministre?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nëse ju keni kohë, patjetër që mund të shqyrtojmë bashkë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zonja Ministre, kjo është pjesë e shqyrtimit të projektligjit tjetër?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj – ... megjithatë është zëvendësministri. Për të hequr merakun e zotit deputet, jemi brenda OECD-së dhe kemi asistencën e tyre. Besoj që zëvendësministri do të jetë në vijim.

Rudina Hajdari – Faleminderit, zonja Ministre për praninë tuaj!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Anila Denaj - Nuk ka problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kurse unë jam me profilin që çdo rritje duhet të jetë e maturuar, ndryshe krijon kosto në të ardhmen.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të jeni i sigurt që kanë marrë fonde shtesë.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Integrimin Europian

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019 Ora 12:00

Drejton mbledhjen:

Rudina Hajdari – kryetare Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”

Marrin pjesë:

Rudina Hajdari, Senida Mesi, Musa Ulqini, Taulant Balla, Mirela Kumbaro, Arben Kamami, Andrea Marto, Ralf Gjoni, Nikolin Staka, Edlira Hyseni, Kostaq Papa, Artemis Dralo dhe Ervis Meço

Mungojnë:

Fatmir Velaj, Senida Mesi, Sadri Abazi.

Të ftuar:

Elton Haxhi – Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Financave

Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike dhe Fiskale

Delina Ibrahimimi – Drejtore në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve

Rudina Hajdari - Kalojmë në shqyrtimin e projektligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”. Të pranishëm kemi zotin Elton Haxhi, zëvendësministër në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë, zotin Lera, drejtor i Përgjithshëm, si dhe zonjën Ibrahimini.

Fjalën e ka zoti Haxhi.

Elton Haxhi – Përshëndetje të gjithëve!

Përpara keni projektligjin “Për shkëmbimin automatik të informacionit financiar”. Ky projektligj vjen në zbatim të disa akteve ligjore dhe nënligjore, të cilat janë nënshkruar nga Shqipëria në kuadër të bashkëpunimit me organizatën e OECD-së dhe me një nga iniciativat që ka kjo organizatë në lidhje me këtë shkëmbim informacioni.

Objektivi i këtij projektligji është që të rregullojë dhe të detyrojë institucionet raportuese, bankat dhe institucionet që mbajnë llogari, për transmetimin e të dhënave kryesisht të individëve jo rezidentë shqiptarë dhe të entiteteve jo rezidente shqiptare, të cilat kanë llogari në sistemin bankar shqiptar. Kjo platformë jep dhe merr informacion. Duke qenë pjesë e kësaj platforme Shqipëria ka avantazhin të marrë informacion në lidhje me llogaritë e rezidentëve shqiptarë në vendet që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje. Pra, ne do të transmetojmë të dhënat e rezidentëve të shteteve të tjera, të cilat janë pjesë e platformës së shkëmbimit dhe në shkëmbim do të marrim informacion për rezidentët shqiptarë, të cilët kanë llogari në sisteme bankare të huaja, duke përfshirë edhe llogaritë në vendet *offshore*.

Avantazhet në drejtim të transparencës dhe të identifikimit të rasteve që përbëjnë evazion fiskal janë të panumërta pasi, në përfundim të këtij procesi, nga përpunimi i të dhënave, mund të identifikohen vlera monetare, të cilat janë përfituar nga rezidentë shqiptarë apo kompani shqiptare, por që mbahen në llogari të bankave të sistemeve të huaja.

Ligji hyn në fuqi menjëherë dhe parashikon që transmetimi i parë i informacionit të ndodh brenda vitit 2020. Sipas afateve që ka përcaktuar marrëveshja, autoriteti përgjegjës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është e detyruar ta shkëmbejë këtë informacion brenda shtatorit të vitit 2020, kurse bankat kanë afat, sipas versionit që ju keni në tavolinë, që ta sigurojnë këtë informacion brenda majit të vitit 2020. Informacioni se do të sigurojmë bankat shkon mbrapa në kohë, pra nuk bëhet fjalë për gjendjet e llogarive në fillim të vitit 2020, por për gjendjet e llogarive dhe disa elementeve të tjera të llogarive, që mund t’i përmendim në vijim, duke filluar nga data 1 janar 2019. Pra, bankat duhet të identifikojnë gjithë individët jorezidentë dhe shoqëritë jorezidente, që janë subjekte të këtij transmetimi dhe ta japin këtë raport për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve fillimisht, duke përfshirë gjendjet e llogarive, interesat, dividendët dhe fitimet, që kanë si burim shitjen e aktiveve financiare.

Gjithë informacioni transmetohet te Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, e cila e përpunon informacionin, e grupon sipas vendeve me të cilat do të shkëmbehet ky informacion dhe e transmeton në mënyrë të sigurt, duke respektuar gjithë kërkesat e konfidencialitet me autoritetet tatimore që janë pjesë e kësaj platforme. Në këmbim pritet të merret i njëjti informacion nga autoritetet e tjera tatimore.

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë, zoti Haxhi!

Dua t'ia jap fjalën zotit Kasneci për përfarimin e legjislacionit të BE-së.

Zoti Kasneci, ju lutem, fjala është për ju!

Dedë Kasneci – Faleminderit, zonja kryetare!

Siç u prezantua edhe nga përfaqësuesi i qeverisë, projektligji “Për shkëmbimin automatik të informacioneve të llogarive financiare” ka si qëllim përafrimin me legjislacionin përkatës të BE-së, konkretisht, me direktivën Këshillit 2011/16, të datës 15 shkurt 2011, për bashkëpunimin administrativ në fushën e tatimeve, e cila shfuqizon një direktivë tjetër, e amenduar.

Shërbimi ynë ka analizuar përputhshmërinë e projektligjit. Për një përafrim më korrekt dhe më të saktë kemi bërë një sugjerim, që nuk është thelbësor, por ka të bëjë vetëm me shënimin në fund të faqes, pra me numrin Celex.

Për efektivitetin e kohës suaj, e kemi dakordësuar edhe me përfaqësuesit e qeverisë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari - Zoti Kasneci, kam një pyetje për ju në lidhje me këtë projektligj: a ka praktika të tilla në Bashkimin Europian?

A mund të na thoni disa nga vendet ku ndiqet ky shembull?

Dedë Kasneci – Në përgjigje të pyetjes suaj, zonja kryetare, projektligji përfaron direktivën e Bashkimit Europian. Direktiva përkatëse për shkëmbimin automatik të të dhënave është një akt ligjor, i cili është i detyrueshëm për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Pra, direktiva është një nga instrumentet e detyrueshme në qëllim. Pastaj mjetet dhe metodat u lihen shteteve anëtare.

Direktiva ka afatin e miratimit dhe zbatimit të saj. Ajo është amenduar disa herë dhe është e detyrueshme për të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian, pa përjashtim. Pra, kjo është një praktikë e të gjitha shteteve. Madje, direktiva ka ardhur duke u shfuqizuar, pra duke zgjeruar kategorinë e të dhënave dhe të afateve kur bëhet ky shkëmbim informacioni, gjithmonë duke respektuar (siç pyeti edhe deputeti, zoti Gjoni) ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, që ne e kemi përafruar me legjislacionin e BE-së dhe do të përafrohet përsëri, sepse BE-ja ka miratuar një paketë të re dhe shumë të rëndësishme në këtë fushë.

Faleminderit!

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë, zoti Kasneci!

Në fakt, kam një pyetje, ndoshta edhe për sqarim. Dua të di nga zoti zëvendësministër: si do t'i merrni informacionet për llogaritë *offshore*, duke marrë parasysh që këto llogari janë shumë të fshehta dhe se ky është synimi i krijimit të këtyre llogarive *offshore*?

Si pretendoni t'i merrni këto informacione?

Faleminderit!

Elton Haxhi - Nëse vendi ku mbahen llogaritë është pjesë e marrëveshjes, e ka marrë përsipër detyrimin për transmetimin e këtij informacioni.

Në listë i kam të gjitha vendet që e kanë nënshkruar marrëveshjen dhe janë bërë pjesë e kësaj platforme.

Në vitin 2017 marrëveshjen e kanë nënshkruar 49 vende, ku janë pothuajse të gjitha vendet e Bashkimit Europian, por edhe vende të tjera, përtej BE-së.

Si *offshore* mund të përmend Bahamasin. Belizi, që është një tjetër parajsë fiskale, është pjesë e kësaj marrëveshjeje dhe e ka nënshkruar në 2018-n. Monako është gjithashtu pjesë e kësaj marrëveshjeje.

Në momentin kur vendi është bërë pjesë e kësaj marrëveshjeje, ka detyrimin të japë informacion në lidhje me shtetasit e huaj, të cilët kanë llogari në sistemin bankar. Informacioni është konfidencial, pra nuk është publik, transmetohet vetëm në autoritetet raportuese, që zakonisht janë autoritete tatimore, të cilat, edhe kur e marrin informacionin, e trajtojnë në mënyrë konfidenciale dhe vetëm për efekte të zbatimit të ligjit.

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë, zoti zëvendësministër!

A ka pyetje të tjera?

Po, zonja...

Edlira Hyseni– Faleminderit të gjithëve!

Kam një pyetje, më shumë praktike, sepse kam qenë në një mision antikorruption në Uashington dhe atje janë trajtuar shumë problemet e antikorruptionit dhe të anës financiare të mbuluar, të fshehur diku në vende të ndryshme nga yni.

Zoti Zëvendësministër, në momentin kur u identifikua fshehja e këtyre parave dhe vendi tjetër dhe informacionin se ekziston kjo shumë parash, a është parashikuar në vazhdim se çfarë do të bëhet me këtë shumë parash të fshehur diku apo të lënë në banka të ndryshme nga bankat shqiptare? Pra, cila do të jetë vazhdimësia e procedurës? Sepse ka shumë teori të ndryshme se si do të përdoren këto para të pajustificuara.

Pra, si do të sekuestrohen këto para? Mbas sekuestrimit çfarë do të ndodhë me to? A do të vihen në funksion të shtetit shqiptar (nëse paratë janë tonat), të qytetarëve shqiptarë dhe të të mirave në këtë vend, përderisa kanë dalë nga këtu?

Faleminderit!

Elton Haxhi – Në rastet e një detyrimi tatimor, i cili nuk është deklaruar në Shqipëri... Edhe një herë, bëhet fjalë për ata që kanë rezidencën në Shqipëri. Nëse janë shtetas shqiptarë dhe rezidencën tatimore nuk e kanë në Shqipëri, pra nuk deklarojnë për të ardhurat globale në Shqipëri, nuk janë subjekt i këtij deklarimi.

Në rastin kur individët janë subjekt i rezidencës tatimore në Shqipëri, kur kemi edhe një të ardhur të padeklaruar, për të cilën nuk është paguar tatimi në Shqipëri, atëherë zbatohen të gjitha dispozitat e procedurave tatimore, që i parashikojnë ligjet e vendit. Pra, nuk është më subjekt... Ky ligj rregullon vetëm transmetimin e informacionit dhe detyrimin e sistemit tonë bankar për ta dhënë këtë informacion. Juridiksionet e tjera kanë një ligj të ngjashëm.

Me marrjen e këtij informacioni dhe me zbulimin e një të ardhure të padeklaruar, i referohemi ligjit përkatës. Nuk trajtohet nga ky ligj.

Rudina Hajdari – Faleminderit shumë, zoti zëvendësministër!

Nëse ka pyetje të tjera, kalojmë në votim.

Kush është dakord me projektligjin? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Ju falënderoj shumë për praninë tuaj, zoti Haxhi dhe zoti Lera!

Ju urojmë një ditë të mbarë!

Faleminderit të gjithë anëtarëve!

MBYLLET MBLEDHJA